

## SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

---

### Shikimi / *el-Muaajeneh* / **المُعَايَنَةُ**

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

"أَلَمْ تَرَ إِلَى رَبِّكَ كَيْفَ مَدَّ الظُّلَّ"

"A nuk shikove nga Zoti yt? - Si e zgjat Ai hijen!"<sup>1</sup> (el-Furkaan, 45)

Ka tri lloje të shikimit.

I pari është shikimi me sy<sup>2</sup>.

I dyti është shikimi me syrin e zemrës<sup>3</sup>, dhe ky është të kuptuarit e thelbit të gjërave në përputhje me cilësitë e tyre, një të kuptuar që i jep fund dyshimit dhe nuk shoqërohet nga mungesa e bindjes. Ky është shikimi nëpërmjet treguesve të dijes<sup>4</sup>.

---

<sup>1</sup> Ka mundësi që shejhu (el-Harawi) këtu të ketë aluduar në të shikuarit e Zotit nëpërmjet manifestimeve të veprimeve dhe të cilësive të Tij.

<sup>2</sup> Ky do të ishte shikimi në realitetet e jashtme të dëshimit me sytë e tanë. Kjo dije empirike gjendet në pozitën më të ulët, duke qenë se, po nuk na çoi në nivelet vijuese, nuk na bën dobi.

<sup>3</sup> Kjo është të kuptuarit e zemrës përkundrejt shikimit të syrit në nivelin paraprak. Kjo është më e rëndësishme, meqenëse kështu sheh realitetet përtej formave. Allahu thotë:

"Vërtet, nuk janë sytë ata që verbohën, por zemrat në gjokse verbohën." (el-Haxh, 46)

<sup>4</sup> Ky është të kuptuarit që bazohet në reflektimin e udhëzuar dhe në lajmet e vërteta (*el-khaber es-saadik*). Ky është fryti i dijes për shenjat e krijuara të Allahut (në univers) dhe shenjat e folura të Tij (në Libër).

I treti është shikimi me syrin e shpirtit, dhe ky është syri që sheh realitetin<sup>5</sup> me qartësi të plotë. Në të vërtetë, shpirtat dëliren dhe nderohen vetëm nëpërmjet qëndrueshmërisë<sup>6</sup> për të shikuar dritën e pranisë (hyjnore), për të dëshmuar shkëlqimin e madhësisë (hyjnore) dhe për të tërhequr zemrat<sup>7</sup> në afërsi të pranisë (hyjnore)<sup>8</sup>.

---

<sup>5</sup> Ky, sipas shumicës së komentuesve, është realiteti me 'r' të vogël, që i referohet realiteteve të ekzistencës. Nëse kjo ka të bëjë me Zotin, atëherë u referohet shpirtave të dëlirë, të cilët kanë bindje të plotë dhe lidhjen më të fortë që u mundëson të shikojnë Zotin në dynja me sytë e tyre shpirtëror.

<sup>6</sup> Siç thotë Ibn el-Kajjim në *Medaarixh*, kjo qëndrueshmëri, pas dëlirjes së plotë, është shkalla më e lartë. Vetasgjësimi ontologjik as nuk është i mundshëm, as nuk është i kërkuar, ndonëse disa aspekte të vetasgjësimit (*fanaa*) mund të jenë një urë e nevojshme për te kjo qëndrueshmëri e përligjur (*bekaa*).

<sup>7</sup> *Nefsi* (egoja) dhe shpirti shkëmbehen në Shpallje, por në terminologjinë e dijetarëve të disiplinës së pastrimit shpirtëror (*suluk*), kur thuhet se *nefsi* bëhet zemër dhe zemra bëhet shpirt, ata mendojnë në atë sesi *nefsit*, pasi t'i hiqen të metat, i referohet si zemër të cilës, kur të pastrohet më tej, i referohet si shpirt, duke e bërë kështu shpirtin stolin e shkallëve (stacioneve) më të larta.

<sup>8</sup> Pejgamberi ﷺ tha:

“Ta dini se asnjëri prej jush s’do ta shohë Zotin e vet, derisa të vdesë.” (Muslim)

Të gjitha format e dëshimit dhe e të shikuarit i referohen bindjes së shtuar, qartësisë së mendjes dhe përfaqësimit shpirtëror të objektit të vëmendjes, të adhurimit dhe të admirimit.